

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 43, pika 1,2/c,3, nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Ky kriter është vendosur referuar nenit 43 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku thuhet “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare” si dhe në mbështetje të nenit 55 pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: **4,747,800 x 40% = 1,899,120 leke**

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin *pasqyrat financiare (bilancet)* për vitet 2021, 2022, të konfirmuara nga Dega e Tatim Taksave, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, paragrafi 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Paraqitja e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare neni 22, pika 1&2.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar (neni 29)

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon nga Operatori ekonomik:

- 2.3.1 **Autorizim** nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat pjese kembimi si në objektin e prokurimit. Në rast se, do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.2 Listë të personelit kryesor (inxhinier mekanik, mekanik xhenerik, mekanik motorrist), të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Lista e personelit kryesor duhet të shoqerohet nga CV-të, diploma universitare, licencat profesionale, deshmi dhe kontrata pune per vitin 2022.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4/paragrafi 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 40, pika 5/b,c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.3 Liste te mjeteve, pajisjeve dhe ambienteve ku te vertetoje se ka të paktën:

- a) një servis të specializuar për kryerjen e shërbimeve të nevojshme gjatë periudhës së garancisë (repart xhenerik, repart motorrik) dhe magazine për pjesë këmbimi për llojin e pjesëve objekt i kësaj procedure prokurimi, me vendndodhje në Shqipëri, i regjistruar në ekstraktin e regjistrimit të dhenat e subjektit ose në rast të marrjes me qera të paraqesë kontrate noteriale qeraje sipas Kodit Civil.
- b) një mjet transporti, i regjistruar në ekstraktin e regjistrimit të dhenat e subjektit ose në rast të marrjes me qera të paraqesë kontrate noteriale qeraje sipas Kodit Civil, të pajisur me certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor të regjistruar në ekstraktin e QKB, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore në mbështetje të ligjit 8378 date 22.07.1998 Kodi Rrugor, police për sigurimin e detyrueshëm të mbajtjesit të mjetit për përgjegjësi ndaj paleve të treta në mbështetje të dekretit nr. 6077, date 22.02.2009 dhe ligjit nr 10076 date 12.02.2009).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 40, pika 5/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.4 Liste ku te deshmoje pervoja të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së perlllogaritur të kësaj kontrate. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të

legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.5 Certifikatë Personale ISO 14001-2015 te standartit nderkombetar te menaxhimit te mjedisit dhe /ose te njevllefshme ose standart ISO me e avancuar (e perkthyer e noterizuar), te cilat do te garantonin cilesine e produktit dhe sherbimeve. Çertifikata duhet te jete e vlefshme, e perditesuar dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetar akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Ne Çertifikate personale ISO 14001:2015 duhet te jete e perfshire objekti i prokurimit. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të LPP dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun e prodhuesit (te perkthyer dhe noterizuar) per mallrat objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikulli që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje deklarate ku te specifikoje se motorri objekt i procedures se prokurimit eshte i ri dhe i paperdorur me parë.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, eshte vendosur në përputhje me piken 6, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje mallin qe duhet te ofrohet sipas afateve te garancise te dhena nga prodhuesi ose distributori i autorizuar. **Argumentimi:** Te dhenat teknike te mallit ne garanci te prodhuesit per kembim, i japin siguirne AK qe OE ofertues eshte ne gjendje te realizoje kontraten sipas kushteve dhe kriterëve te percaktuara ne dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 pika 3/b, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike të mallrave i referohen tabelës si më poshtë:

MJETI KOMPAKTOR “YTO GROUP CORPORATION”/YTO me 4 rrota metalike të dhembzuara, perdoret eskuzivisht në venddepozitimet e trajtimit të mbetjeve urbane nepermjet të cilit kryhen proceset themelore të shtyrjes dhe ngjeshjes së mbetjeve. Peshë prej 35000 kg është e përqendruar në rrotat metalike të dhembzuara të cilat kanë jan elementet kryesore të kryerjes së procesit të ngjeshjes.	
a	Vit prodhimi 2011
b	Model LLC 233H
c	Peshë 35000 kg
TE DHENA TEKNIKE TE MOTORRIT	
a	Motorr diesel "CUMMINS"
b	Model QSM11
c	Nr. serial 71014905
d	Fuqia 276 kw
dh	Numri i cilindrave 6
e	Numri i rrotullimeve 2100 r/min
f	Shpejtesia 600-1200 r/min
g	Lloji i transmisionit hidrostatik neutral braking



Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Malli (motor QSM11) i kerkuar ne DST, te jete ne perputhje te plote me kerkesat dhe specifikimet, bazuar ne llojin dhe tipin e mjetit kompaktor, te cilat jane vendosur ne perputhje me manualet e operimit dhe mirembajtjes te vena ne dispozicion nga prodhuesi.
2. Malli (te jete i ri dhe original, i ambalazhuar ku te identifikohen te gjitha specifikimet, marka, numri referues, i shoqeruar me certifikaten e origjines i konfirmuar per pershtatshmerine nga prodhuesi) si dhe te kete te specifikuar te gjithe parametrat teknike ne treguesin e montuar ne motor dhe garancine
3. Dorezimi mallit do te behet ne magazinën e Autoritetit Kontraktor dhe me tej do te vijohet me montimin ne mjetin kompaktor i cili ndodhet ne venddepozitim.

4. Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi <i>mall / shërbim / punë</i>	Njesia	Sasia
B	MJETI KOMPAKTOR MODEL LLC 233H, Vit prodhimi 2011,		
1	Motorr i ri diesel "CUMMINS", model QSM11, Nr. serial 71014905, fuqi 276 kw, Numri i rrotullimeve 2100 r/min, Numri i cilindrave 6, Shpejtesia 600-1200 r/min, Lloji i transmisionit hidrostatik neutral braking	cope	1
		cope	

Afatet e lëvrimit:

	Emertimi	Destinacioni	Sasia	Periudha e dorezimit ne dite
A	MJETI KOMPAKTOR MODEL LLC 233H, Viti i prodhimit 2011, Motorr diesel "CUMMINS", model QSM11/WP 12N Nr. serial 71014905 dhe fuqi 276 kw.			
1	Furnizim-vendosje motor i ri diesel "CUMMINS", model QSM11, Nr. serial 71014905, fuqi 276 kw, Numri i rrotullimeve 2100 r/min, Numri i cilindrave 6, Shpejtesia 600-1200 r/min, Lloji i transmisionit hidrostatik neutral braking	Landfill	1	10

Perllogaritja e vleres limit per proceduren e hapur e thjeshtuar me objekt prokurimi ***“Furnizim-vendosje motorr i ri per mjetin kompaktor YTO, model LLC 233H, Viti 2011, motorr diesel “CUMMINS”, model QSM11, Nr. serial 71014905 dhe fuqi 276 kw, 2100 r/min”***,, eshte llogaritur ne zbatim ligjit 162/2020 “Prokurimit Publik”, neni 35 dhe VKM 285, date 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 13 “Studimi paraprak i tregut”, pika 2,3,4,5 si dhe te urdherit Nr.10, date 15.06.2023 te Autoritetit Kontraktor “Bajkaj Land“ Sh.a per ngritjen e Njesise se Prokurimit.